VENDIM
Nr. 65, datë 8.2.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI I AKSEVE RRUGORE 'UNAZA LINDORE, LOTI II' DHE PROBLEMATIKAT E RRUGËVE DYTËSORE TË OBJEKTIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i akseve rrugore 'Unaza Lindore, loti II' dhe problematikat e rrugëve dytësore të objektit".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall", "arë" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 51 783 837.3 (pesëdhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë pikë tre) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 51 783 837.3 (pesëdhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë pikë tre) lekësh, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare" dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
8. Autoriteti Rrugor Shqiptar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuara.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I AKSEVE RRUGORE "UNAZA LINDORE LOTI II" DHE PROBLEMATIKAT E RRUGËVE DYTËSORE TË OBJEKTIT”.

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas zvrpp)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË										Konfirmimet	SHËNIME	Adresa
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr.pas	Lloji .pas	Sip.Totale(m2)	Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "truall"			Ndërtesë banimi (shtëpi)			VLERA TOTALE (lekë)			
								Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip.Ndërt. konf. ZVRPP (m2)	Çmimi mes. sh/blerjeve sipas zvrpp (l/m2)	Vlera (lekë)				
1	Syrja	Hysen	Sula	3976	234/124	Truall + ndertes	300			0	120	479	57480	**326.2**	61167	19952675.4	**20010155.4**	Konfirmuar nga Ashk		**Tirane,Shkoze rruga Nikolle Mekajshi**
2	Gezim	Selami	Collaku	3976	233/142	Are+truall+Ndertes	383	174	448	77952	151	479	72329	**257.4**	61167	15744385.8	**15894666.8**	Konfirmuar nga Ashk		**Tirane,Shkoze**
3	Skënder Lulzim	Islam Islam	Isalla Isalla	3976	234/107	Truall+ ndertes	300			0	225	479	107775	**236.3**	61167	14453762.1	**14561537.1**	Konfirmuar nga Ashk		**Tirane,Shkoze**
4	Muharem	Kalem	Lala	3976	233/229	Are	1278	282	448	126336			0				**126336**	Konfirmuar nga Ashk		**Tirane,Shkoze**
5	Abaz	Alush	Rrahmani	3976	234/27	are	498	95	448	42560			0				**42560**	Konfirmuar nga Ashk		**Tirane,Shkoze**
6	Sefer	Ramazan	Cinga	3976	236/28	truall	500			0	26	479	12454				**12454**	Konfirmuar nga Ashk		**Tirane,Shkoze**
	Anila	Sefer	Hoxha																	
	Saimir	Sefer	Cinga																	
	Engjellushe	Sefer	Shkalla																	
7	Hasan	Musa	Qordja	3550	170/2	are	10060	2299	448	1029952			0				**1029952**	Konfirmuar nga Ashk	Ka dale ne vkm 221 date 13.4.2022per siperfaqen 542 m2	**Tirane,Surrel**
8	Aleks	Jaho	Ymeri	3976	170/74	are	780.7	52	448	23296			0				**23296**	Konfirmuar nga Ashk	Vendoset Barre Hipotekore NGA DREJTORIA E PERGJITHSHME E TAKSAVE VENDORE TIRANE SHKRES NR 123403 PROT DT.04.8.2016 ZVRPP NR.26264. DT. 08.08.2016	**Tirane**
9	Andrea	Hysen	Sula	3976	234/117	are	280	151	448	67648			0				**67648**	Konfirmuar nga Ashk		**Tirane, Rruga Idriz Dollaku**
10	Andrea	Çaush	Shuli	3976	170/51	are	370	34	448	15232			0				**15232**	Konfirmuar nga Ashk	MBI KETE PASURI POZICIONOHET 170/51-ND VOL 19FQ121 L. LEG	**Tirane, Rruga Kostandin Shpataraku**
Vlera Totale																	**51783837.3**			